VENDIM
Nr.686, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.922, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR "SEKRET SHTETËROR", QË PRODHOHET, RUHET, PËRPUNOHET APO TRANSMETOHET NË SISTEMET E KOMUNIKIMIT (INFOSEC)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror"", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun II, shkronja "E" "Sigurimi i komunikimeve", të vendimit nr.922, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, fjalët "…, strukturë në varësi të Shërbimit Informativ të Shtetit, …", shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha